

**I** FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:  
Informacion për pacientin

# LEVOMEPROMAZINE

Drazhe – 25 mg

(*Levomepromazinë maleat*)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**

- Çfarë është Levomepromazine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Levomepromazine
- Si ta merrni Levomepromazine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Levomepromazine
- Informacion i mëtejshëm

## 1. ÇFARË ËSHTË LEVOMEPROMAZINE DHE PËRSE PËRDORET

Levomepromazina bën pjesë në grupin e neuroleptikëve fenotiazinikë. Ajo vepron në hipotalamus, talamus, formacionin retikular dhe në sistemin limbik, duke frenuar impulset ndijore.

Levomepromazina antagonizon receptorët D2 - dopaminergjikë, 5HT3 - serotoninergjikë, H1 - histaminergjikë dhe ata kolinergjikë (muskarinikë).

Si rezultat i këtij antagonizmi shfaqet një efekt qetësues në doza të vogla, një efekt antipsikotik në doza të larta, si edhe rritje e pragut të dhimbjes dhe nxitje e amnezisë.

Levomepromazina ka edhe efekt analgjëzik, antihistaminik dhe antikolinergjik.

Bari nuk jep deprimim të theksuar të frymëmarrjes dhe prandaj është i dobishëm sidomos në të sëmurët me rezervë të ulët respiratore.

Levomepromazine përdoret për trajtimin e:

- psikozave, për të kontrolluar eksitimin dhe hiperaktivitetin psikomotor në depresion mesatarisht të rëndë;
- skizofrenisë;
- çrregullimeve psikotike me haluçinacione;
- çrregullimeve të personalitetit në të sëmurët epileptikë;
- çrregullimeve neurotike;
- dhimbjeve mesatarisht të rënda ose të rënda para ndërhyrjeve kirurgjike;
- të vjellave.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI LEVOMEPROMAZINE Mos merrni Levomepromazine në qoftë se:

- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj levomepromazinës ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të barit;
- jeni i ndjeshëm ndaj fenotiazinave në përgjithësi;
- jeni në gjendje komatoze;
- vuani nga sëmundje të rënda të mëlçisë;
- vuani nga sëmundje të rënda të veshkave;
- vuani nga sëmundje të rënda të miokardit;
- vuani nga sëmundje e hipotensionit të theksuar;
- vuani nga feokromocitoma;
- keni depresion të SNQ;
- keni suprimim të palcës së kockave.

**Tregoni kujdes të veçantë me Levomepromazine**  
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Levomepromazine. Kujdes i veçantë duhet treguar në fëmijët, të moshuarit dhe në periudhën e shtatzënisë.  
Në qoftë se nevojitet një mjekim afatgjatë me levomeproma-

zinë, atëherë duhen kryer analizat e gjakut dhe provat e funksionit të mëlçisë.  
Bari mund të shkaktojë përgjumje, çorientim, konfuzion dhe hipotension të ndjeshëm, çka mund t'i dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri. Më të rrezikuar për hipotension janë pacientët mbi 50 vjeç.

Gjatë periudhës së mjekimit duhen mënjanuar pijet alkoolike. Levomepromazina duhet përdorur me kujdes në të sëmurët me glaukomë ose hipertrofi të prostatës, për shkak të efekteve antikolinergjike që ajo jep.  
Levomepromazina duhet të përdoret me kujdes në pacientët me sëmundje kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe sëmundje të rënda respiratore, në sëmundjen e Parkinsonit, epilepsi, në prezencë të infeksioneve akute ose leukopenisë, në hipertiroidizëm, në pacientët që kanë histori të ikeritit dhe në miasteni grave.

Në doza të larta mund të ndodhë ndjeshmëri nga drita, ndaj duhet shmangur ekspozimi direkt në diell.  
Barnat antipsikotikë nuk duhet të përdoren në pacientët e moshuar për të trajtuar psikozat e lehta dhe mesatare. Doza fillestare e antipsikotikëve në të sëmurët e moshuar duhet të reduktohet (gjysma e dozës së të rriturve), duke marrë në konsideratë faktorë si pesha, sëmundshmëria dhe trajtimet e tjera. Trajtimi duhet të kontrollohet vazhdimisht.

### Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Levomepromazine.

Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Levomepromazine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.  
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- fenotiazina të tjera dhe deprimues të sistemit nervor qendror (anestezikët, alkooli, antihistaminikët, barbituratet, narkotikët, tranquilizuesit) sepse levomepromazina rrit efektin e tyre, kështu që dozat e këtyre barnave duhen ulur përgjysmë në rastet kur përdoren njëherësh me levomepromazinën;
- antikolinergjikë, miorelaksues dhe insekticide fosforoorganike sepse bari mund të rrisë efektin e tyre;
- barna që zgjasin intervalin QT;
- barna që ndryshojnë nivelin e elektrolitëve;
- antihipertensivë; gjithashtu mund të antagonizohet efekti i guanetidinës dhe barnave të ngjashme;
- klonidinë, sepse levomepromazina mund të fuqizojë efektin hipotensiv apo efektet qendrore të saj;
- amiodaron, dronedaron, moksifloksacin, citalopram, escitalopram, piperakinë me artenimol, pimizid, sakuinavir, rritet risku për aritmi ventrikulare; të shmanget përdorimi i njëkohshëm;
- disopiramid, ritonavir, sotalol, pentamidinë isetionat;
- propranolol, sepse ai redukton metabolizmin hepatic të fenotiazinave, ndërsa këto të fundit ulin metabolizmin hepatic të propranololit;
- barna që bllokojnë receptorët dopaminergjikë në SNQ, si droperidoli, haloperidoli, metoklopramidi, olanzapina, risperidoni;
- antiepileptikë, sepse antipsikotikët kundërshtojnë efektin antikonvulsiv të tyre;
- litium, sepse rritet risku për efekte anësore ekstrapiramidale dhe neurotoksicitet;
- artemeter me lumefantrinë, desferrioksaminë, të shmanget përdorimi i njëkohshëm;
- adrenalinë dhe agonistë të tjerë adrenergjikë;
- barna antiparkinsonike, si levodopa, pergolid, pramipeksol ose ropinirol;
- antiacidë, sepse ulin përthithjen e levomepromazinës;
- kontraceptivë oralë, kinolone, sulfonamide, sulfanilureikë, tetraciklina, diuretikë tiiazidikë, analogë të vitaminës A, sepse përdorimi i njëkohshëm me fenotiazina rrit ndjeshmërinë ndaj dritës të këtyre barnave.

**Marrja e Levomepromazine me ushqim dhe pije**  
Levomepromazine nuk duhet të merret me alkool.

### Shtatzënia Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.

Levomepromazine nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë, vetëm në qoftë se mjeku e sheh të nevojshme dhe matet faktori risk / përfitim.

Prandaj, gjithmonë konsultohuni me mjekun tuaj përpara se të përdorni Levomepromazine gjatë shtatzënisë.

**Ushqimi me gji**  
Levomepromazina kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet të përdoret gjatë ushqimit të foshnjes me gji.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**  
Levomepromazine mund të shkaktojë përgjumje, çorientim, konfuzion dhe hipotension të ndjeshëm, çka mund t'i dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

### Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Levomepromazine

Ky bar përmban laktozë dhe sukrozë. Nëse jeni në dijeni se keni intolerancë nga disa sheqerna, duhet të flisni me mjekun tuaj përpara se të përdorni Levomepromazine.

### 3. SI TA MERRNI LEVOMEPROMAZINE

Gjithmonë merreni Levomepromazine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Levomepromazine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.  
Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysmë gote ujë. Mund t'i merrni tabletat me ose pa ushqim.  
Dozimi ndryshon sipas indikimit dhe objektivit që kërkohet të arrihet. Përgjithësisht këshillohet që trajtimi të fillojë me doza të ulëta, që rriten gradualisht deri në dozën optimale.

*Në trajtimin e skizofrenisë*  
12.5 – 50 mg në ditë në 3 – 4 doza të ndara. Për të sëmurët me regjim shtrati mund të përdoren 100 – 200 mg në ditë, në 3 – 4 doza të ndara; në rast nevoje doza mund të rritet deri në 1 g në ditë.  
Megjithatë, doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Levomepromazine**  
Në qoftë se keni marrë më shumë Levomepromazine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.  
Simptomat e mbidozimit janë të ngjashme me simptomat e parkinsonizmit.

**Në qoftë se harroni të merrni Levomepromazine**  
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.  
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

**Në qoftë se ndërprisni marrjen e Levomepromazine**  
Përdorimi i këtij bari nuk duhet të ndërpritet menjëherë! Reduktimi i dozës duhet të jetë gradual.  
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, levomepromazina mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.  
Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë:

- përgjumja dhe astenia;
- ndonjëherë mund të shkaktojë tharje goje.

Në të sëmurët e moshuar mund të shkaktojë hipotension. Janë konstatuar edhe takikardi, simptoma ekstrapiramidale, agranulocitozë dhe leukopeni.


Në të sëmurët që mjekohen për një periudhë të gjatë kohe dhe me doza të larta mund të shfaqen reaksione të ngjashme me parkinsonizmin.  
Mund të ndodhë hiperglicemi ose ndonjëherë rritje e eritrosedimentit.  
Mund të shfaqen edhe efekte të tjera të padëshirueshme që janë të zakonshme për neuroleptikët fenotiazinikë.  
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.



**5. SI TA RUANI LEVOMEPROMAZINE**  
Mbajeni larg fëmijëve.  
Mos e përdorni Levomepromazine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.  
Mos e ruani mbi 25°C.  
Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita.

**6. INFORMACION I MËTEJSHËM**  
**Çfarë përmban Levomepromazine - drazhe**  
**Lënda vepruese** është Levomepromazinë maleat.  
Çdo drazhe përmban 25 mg levomepromazinë maleat.  
**Përbërësit e tjerë** janë: amidon, laktozë monohidrat, xhelatinë, stearat magnezi, talk, povidon, karbonat kalçiumi, sukrozë, dioksid titani, Opaglos i bardhë 6000, Opalux i gjelbër.

**Përmbajtja e paketimit**  
Kuti me 30 drazhe.

**Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:**

 Sipas recetës së mjekut.

 Përmbajtja.  Kujdes.

 Forma e tabletës.

**Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:**

 **PROFARMA Sh.a.**  
Rruga "Myslym Keta"  
Tel.: 00 355 4 23 89 602  
Tiranë - SHQIPËRI

**Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Shtator 2015.**